



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**  
**SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT**

**Datë: 28 janar 2013**

Në mbështetje të nenit 12 dhe 13 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121, si dhe nenit 18 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sekretariati shpall:

**KONKURS**  
**Për plotësimin e vendit të punës:**

**1.**

**Pozita:** Këshilltar Juridik (Senior)  
**Kodi:** GJ-DL 02-09  
**Numri i vendeve të punës:** 1 (një)  
**Kohëzgjatja e kontratës:** Pa afat  
**Puna Provuere:** Një (1) Vit

**Përshkrimi i Përgjithshëm i Pozitës:** Nën mbikëqyrje të Këshilltarit të Parë Juridik dhe gjyqtarëve përkatës mbështet punën profesionale të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese duke bërë hulumtime ligjore dhe analiza dhe duke ndihmuar në hartimin e vendimeve, raporteve dhe materialeve të tjera juridike të hartuara nga Gjykata Kushtetuese.

**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:**

- Përgatitja e raporteve, hartimi i vendimeve, seancat shqyrtuese, analiza ligjore dhe tekstet tjera lidhur me juridiksionin e Gjykatës;
- Kontribuimi për funksionim efektiv dhe efikas të Njesisë Ligjore;
- Kryerja e punëve tjera sipas nevojës për shqyrtim dhe vendimmarrje të Gjykatës;
- Monitoron dhe udhëzon këshilltarët e rinj juridik dhe Zyrtarët Ligjor lidhur me detyrat që u janë caktuar atyre në rastet individuale.

**Kualifikimet minimale dhe përvoja e përgjithshme:**

- Përgatitje superiore shkollore në shkencat juridike, preferohen trajnime ose specializime në të drejtën kushtetuese, të drejtat e njeriut, të drejtën ndërkombëtare publike apo drejtim tjetër të së drejtës publike;
- Së paku dy (2) vite të përvojës përkatëse profesionale në çështjet juridike;
- Të jetë person me integritet të lartë personal dhe moral.

Kandidati për pozitën e Këshilltarit Juridik duhet të posedojë njohuri të thella profesionale, si dhe aftësi të shkëlqyeshme hulumtuese, analitike dhe organizative. Preferohet të ketë provimin e Jurisprudencës si dhe përvojë në gjyqësi.

Po ashtu, Kandidati duhet të demonstrojë qasje pragmatike në gjetjen e zgjidhjeve adekuate me burime të kufizuara, të ketë aftësi të zhvilluara komunikimi (në mënyrë verbale dhe me shkrim), të ketë aftësi për të identifikuar prioritetet, të ketë aftësi për të bashkëvepruar me

maturi dhe ndjeshmëri me kolegë dhe palë; të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efikase nën presion kohor; të ketë aftësi për të trajtuar informatat e besueshme në mënyrë të duhur; të ketë aftësi të shkëlqyeshme në përdorimin e kompjuterit, dhe hulumtimit në internet. Kandidati duhet të njohë gjuhën shqipe dhe serbe, si dhe të ketë njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze në të folur dhe në të shkruar.

### **Informata të Përgjithshme për Kandidatë**

Përcaktimi i pagës, për pozitën e shpallur, bëhet në përputhje me Rregulloren e Punës dhe Vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese ofron mundësi të barabarta punësimi dhe mirëpret aplikacionet nga personat e komuniteteve jo shumicë dhe nga kandidatët femra. Politika e përfaqësimit gjinor dhe të të gjitha komuniteteve të Kosovës do të zbatohet gjatë procesit të punësimit në Sekretarinë e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

### **Procedura e Konkurrimit**

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin aplikacionin përkatës, të shoqëruar nga një biografi profesionale, një letër motivuese dhe dokumentacioni përkatës lidhur me përgatitjet shkollore dhe përvojën e kërkuar të punës. Forma e aplikacionit mund të shkarkohet nga ueb faqja e Gjykatën Kushtetuese [www.gjk-ks.org](http://www.gjk-ks.org)  
Aplikacioni me të gjitha dokumentet duhet të paraqitet nëpërmjet e-mailit në adresën [lulzim.syla@rks-gov.net](mailto:lulzim.syla@rks-gov.net)

Data e fundit për pranimin e aplikacioneve është **12.02. 2013, në orën 24:00.**

### **Shënim:**

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar , vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.